



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:185079
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05626742

Ac.nr.10779/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka -anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M..... E..... nga fshati Sllatinë, Komuna e Kaçanikut, të cilin me autorizim e përfaqëson A..... I..... nga Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës KS “ELSIG”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson .V..... B....., me autorizim, për çështjen juridike kontestuese kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës kundër Akgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm numër C.nr.539/20 të datës 01.11.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës KS “ELSIG”, me seli në Prishtinë, për sa i përket pikës I dhe III të dispozitivit, ndërsa Akgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.539/20 të datës 01.11.2021, **VËRTETOHET**.

II. Pika e II-të e dispozitivit të Akgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.539/20 të datës 01.11.2021, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin, C.Nr.539/20 të datës 01.11.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit M.....E..... nga fshati Sllatinë, Komuna e Kaçanikut, dhe e ka detyruar të paditurën KS “ELSIG” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 14.09.2020, t’ia paguaj edhe atë: **Dëm jo material për:** Dhimbje trupore –fizike shumë prej 2.000,00 euro, Frikën e shkaktuar shumë prej 1.500,00 euro gjithsej shumë prej 3.500,00 euro, **Dëmin material për:** Ndhimën e personit të tretë

210.00 eur, Ushqimin e përforcuar 210.00 euro, për shpenzimet e shërimit 11.00 euro, gjithsej shumë prej 431.00 euro. Të gjitha këto shuma me kamatë, prej 8% duke filluar prej data 28.10.2021, e gjerë në pagesën definitive. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka refuzuar si të bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditësin Mensur Elezi nga fshati Sllatinë, Komuna e Kaçanikut, mbi shumë e miratuar në lartësi prej 1.000.00 euro, edhe atë në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës. Në pikën e III-të të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit, t'ia paguajnë shumë si në pikën I të këtij dispozitivi të Aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 704,00 euro, këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjore, ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndyshojë Aktgjykimin e atakuar apo ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka ushtruar përgjegjeje në ankesë

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi M..... E....., përmes përfaqësusit të tij të autorizuar A.....I....., avokat nga Prishtina, me datë 24.12.2020 ka ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurës kundër të paditurës KS "ELSIG", me seli në Prishtinë për shkak të aksidentit të komunikacionit të datës 14.09.2020, rreth orës 13:40 minuta, i cili ka ndodhur në fshatin Doganaj, Kaçanik, në të cilin aksident, lëndime trupore ka pësuar paditësi M..... E..... Aksidenti i komunikacionit është shkaktuar, kur vozitësi i automjetit të udhëtarëve "Mercedes 190", me targë të rexhistrimit "05-723-EF", të cilin e drejtonte S..... M....., i cili qarkullonte nga drejtimi i fshatit Glloboçicë në drejtim të fshatit Doganaj, gjeqësisht tek "Ura e Lepencit", nga pakujdesia duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, kushteve të rrugës, hynë në kthesë të thellë, me shpejtësi të madhe, përtej normave të lejuara, hynë në urë dhe humbë kontrollin mbi automjet, duke kaluar në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme të anës së majtë godet njësinë "B", në pjesën e përparme të anës së majtë, saktësisht në gomë dhe nga inercioni i goditjes, njësia "B", me anën e djathtë e godet mbrojtësen e urës. Si rezultat i këtij aksidenti, paditësi ka pësuar lëndime trupore të rënda me crast ka pësuar dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar, rehabilitim dhe ka krijuar shpenzime të shërimit, fakte të konstatuara nga ekspertiza e cila gjindet në shkresat e lëndës. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti i komunikacionit ishte i siguruar tek të paditura, andaj përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura, duke i marrë parasysh këto fakte të konstatuara, kanë kërkuar që kërkesëpadija e paditësve të miratohet në tërësi si e bazuar si në precizimin e bërë me shkrim. Shpenzimet i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës si në përgjegje në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura gjyqësore bazën e kërkesëpadisë nuk e ka kontestuar por kërkesë padinë e ka kontestuar për nga lartësia e saj duke theksuar se shumtë e kërkuara janë të larta, nuk janë në harmoni me lëndimet dhe praktikën gjyqësore, pasi që pala paditëse ka lëndim të rëndë pa pasoja. Nga këto baza i ka propozuar gjykatës që pas analizimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj pjesërisht të bazuar. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.539/20 të datës 01.11.2021 me të cilin e aprovuar pjesësisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të Aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 14.09.2020, rreth orës 13:40 minuta, në fshatin Doganaj, Kaçanik”, fakti ky i vërtetuar nga Raporti i aksidentit, raporti i policit hetues, dhe nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse. Se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar nga lëshimet e të siguruarit të të paditurës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në veqanti nga raporti i policit hetues, ku është shënuar se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshime ekskluzive të shoferit të njësiës “1”, i cili ka qenë duke lëvizur nga drejtimi i fshatit Gllloboqicë, në drejtim të fshatit Doganaj, dhe ka lëvizur me shpejtësi jo adekuate konform kushteve të krijuara në komunikacion dhe ka kaluar prej shiritit të rrugës së tij, në shiritin që i takonte për lëvizje automjetit të njësisë “2”. As ky fakt nuk ishte kontestues në mes palëve ndërgjyqëse. Se në këtë aksident paditësi M..... E....., ka pësuar lëndim trupore, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertëve mjekësorë Dr. M..... H..... - Ortoped dhe Dr. N..... M..... - Psikiater, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka pësuar: qarje të kockës së brinjës x të gjoksit të anës së majtë HTA hipertension arterialis dhe ndrydhje në mes brinjëve në anën e majtë të gjoksit, të cilat lëndime janë të rënda trupore. Nga mendimi i ekspertëve Mjekësorë Dr. M..... H..... - Ortoped dhe Dr. N..... M..... – P....., konstatohet se paditësi në aksidentin e lartëcekur ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që kanë zgjatur 30 minuta - koha e kaluar nga aksidenti deri te transporti per mjekim dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 ditë, kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysht lëndimet e brinjëve të cilat nuk mundë të imobilizohen. Të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur për 25 ditë, kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërlidhen me kohën e nevojshme për konsolidimin e krisjes së kockës dhe pamundësisë së imobilizimit që manifestohet me dhimbje në gjdo frymëmarrje, si dhe kontrollat sistematike dhe procedurat diagnostike. Të intensitetit të ulët, kronike ka edhe sot e kësaj dite, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Nga mendimi i ekspertës së psikiatrisë Dr. N..... M..... - Psikiatëre, është konstatuar se paditësi në momentin e aksidentit, ka pësuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda dhe është manifestuar me frikë nga vdekja dhe këccenimi i drejtë për drejtë për ingetritetin e tij fizik. Pastaj kjo frikë ka kaluar në frikë sekondare të intenzitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, kjo frikë është manifestuar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, anktheve, qregullim të gjumit, me rikujtime të ngjarjes traumatike, nervoz dhe iritabilitet. Pastaj

kjo frikë ka kaluar në frikë sekondare të instenzitetit të mesëm, e cila ka zgjatur 2 javë, është manifestuar me vështirësi të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësorë, anktheve për shkak të dhimbjeve në gjoks në gjdo lëvizje e cila i ka shkaktuar stres intensiv, reagimeve me nërvoz dhe iritabilitet me brengën për ecurin e mjekimit, vështirësi gjatë gjumit dhe rikujtime të ngjarjës traumatike. Pastaj kjo frikë ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur për 2 muaj, është manifestuar me vështirësi të adaptimit me kushtet e trajtimit mjekësorë, qrrregullim të gjumit, rikujtimeve të herë pas hershme të ngjarjës traumatike, shqetësimeve gjatë gjumit me pasiguri sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Nga mendimi i ekspertit është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 30 ditë, për kryerjen e disa aktivitete të përditëshme jetësore siq janë përgaditja dhe ofrimi i ushqimit, veshëmbathja, higjena personale. Nga mendimi i ekspertit është konstatuar paditësit i'u është nevojitur ushqimi i përforcuar në kohë zgjatje prej 30 ditësh, i pasur me albumina , vitamina dhe minerale, ushqim më i përforcuar se ushqimi i zakonshëm. Paditësi si rezultat i këtij lëndimi ka pasur edhe shpenzime materiale për shërim, e të cilat shpenzime janë bërë me fajin e të siguruarit të të paditurës, e të cilat shpenzime i përgjigjen shërimit, fakt i konstatuar nga ekspertiza e ekspertëve mjekësore. Në fund, gjykata kërkespadinë e paditësit e miratoi pjesërisht të bazuar, duke e mbështet vendimin e saj në nenin 136,159,169 dhe 183 të LMD-ës. Në raport me llogaritjen e kamatës ligjore gjykata e bazoi vendimin e saj në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së. Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuar në lartësi prej 1.000.00 euro, edhe ate në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës, për arsye se shumat e kërkuara për këtë formë të dëmit ishin të larta dhe nuk ishte në harmoni me lëndimet e pësuar nga paditësi po ashtu nuk ishte edhe në harmoni me praktiken gjyqësore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar pala e paditur me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelsinë e pjesërishtme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të

fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadsisë dhe shumën e aprovuar.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadsisë së paditësit. Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadsisë, Gjykata e Apelit i ka vërtetuar po ashtu edhe shumat e kompensimit, të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të drejtën dispozitat materiale, për shkak se shumat e kompensimit të dëmit material dhe jo material është në harmoni me dëmit e pësuar dhe shkallën e lëndimit të paditëses. Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit, të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se të njëjtat janë të bazuar në nenin 136,159,169 dhe 183 të LMD-ës. Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimi i atakuar të vërtetohet, e të refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve të rënga trupore trupore për paditësin, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 paragrafi 2 të LMD-ës, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfacion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform dispozitës së tillë.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadsisë së paditësit dhe lartësisë së saj. Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimit i atakuar të vërtetohet, e të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenin 382 të LMD-ës.

Po ashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke e vërtetuar si të drejtë mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë konfirm në nenin 452 të LPK-së.

Pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kacanik, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.539/20 i datës 01.11.2021, mbetet e pashqyrtuar bazuar në nenin 194 të LPK-ës, për arsye se pala ankuese këtë pjesë të Aktgjykimit nuk e ka atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të tw paditurws, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10779/2021 , me datën 24.04.2024

**Kryetari i kolegjit
Ardian Ajvazi**